



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1333/2 prot.,

Datë 12.06.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “PERPARIMI/G” SHPK & “2N” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-65937-04-13-2023, me objekt: “Ndërtimi i shkalleve Llapushaj” me fond limit **2,499,896** lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “PERPARIMI/G” SHPK & “2N” SHPK.
Adresa: Lagja Sporti, zona kadastrale nr 1842,pallati 8/287-2,kati perdhe, Gramsh.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gramsh
Adresa: Bulevardi “10 korriku”, Gramsh

Në datën 09.06.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3170 dhe me nr. 1333 prot., datë 09.06.2023 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “PERPARIMI/G” SHPK & “2N” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-65937-04-13-2023, me objekt: “Ndërtimi i shkalleve Llapushaj” me fond limit **2,499,896** lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “PERPARIMI/G” SHPK & “2N” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “PERPARIMI/G” SHPK & “2N” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1333 prot., datë 09.06.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të këtij operatori ekonomik rezulton se:

Në kriteret e kualifikimit është kërkuar;

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Për ofertuesin 2N SHPK me nipt L31615017L, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik 2N SHPK:

- Nuk ka arritur të plotësojë pikën 2.3.6 (e), deklaratën për vendodhjen dhe verifikimin e automjeteve nga autoriteti kontraktor në raste Bashkia Gramsh.

PERPARIMI-G

Në kriteret e kualifikimit është kërkuar;

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

a) 1 (nje) Teknik ndërtimi

b) 1(nje) elektrikist

c) 2(dy) punonjes betonues

d) 2 Suvatues/murator

e) 1(një)Punonjes Manovratore Patente Manovrimi nga DPSHTRR.

f) 2 (dy)shofere

Nisur nga preventivi i punimeve që do të kryej operatorë ekonomik PERPARIMI-G nuk

permbushe kriterin e vendosur ne DST, konkretisht PIKEN 2.3.4 (c)- 2(dy) punonjes betonues. Ne preventivin e punimeve te OE PERPARIMI-G thuhet se do te kryhen "Transport material inerte deri ne 5 km, 178 m3 ", nderkoh ne kriteret e vendosur ne DST. Shtojca 8 nuk ka deklaruar asnje shofer i cili do kryej transportin.

BOE PERPARIMI-G & "2N" shpk ka dorezuar listpagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi, Shkurt 2023 ku rezulton se.

P.N dhe F.Z te punesuar si Betonues sipas vetdeklarimit te OE 2N SHPK rezulton ne baze te listpageses i punesuar me kodin 7115.02 si karpentier, nderkoh duhet te jete me kodin 7114.01.

K.M i punesuar si shoferi kompanis, sipas vetdeklarimit te OE 2N SHPK rezulton ne baze te listpageses i punesuar me kodin 8322.01, nderkoh duhet te jete me kodin 8332.14.

BOE PERPARIMI-G & "2N" shpk kane plotesuar gabim formularin e ofertes ku preventivi eshte plotesuar mbi Shtojca 10, ku ne fakte sipas formatit te DST ky formular plotesohet nga autoriteti kontraktor Bashkia Gramsh.

Sa me sipër BOE PERPARIMI-G & "2N" shpk nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikat 2.3.6, (e) 2.3.4 (c, f), të kriterëve të vendosura në DST sipas shpjegimeve të permendura me sipër.

Per sa me sipër, mbeshitetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, ku shprehimisht parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, oferta e BOE PERPARIMI-G & "2N" shpk skualifikohet.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 12.06.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri